



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 · E-mail: rektorati@uni-pr.edu · eëë.uni-pr.edu

Fakulteti: Bujqësisë dhe Veterinarisë

Departamenti: Agroekonomi

Programi: Msc. Ekonomia e Bujqësisë dhe Ushqimit

NJOFTIM

Në bazë të rregullores për studime master të Universitetit të Prishtinës Nr. 1/334, datë 31.05.2023, Neni 12, pika 3 e kësaj rregulloreje, ju njoftojmë se :

Ekzemplari (drafti) i temës së masterit i punuar nga kandidati/ja BSc. Shpend Kokolli, me titull: **“Ndikimi i mënyrës së kultivimit në produktivitetin dhe profitabilitetin e fermës: Gjetjet në fermat e prodhimit të kulturës së dredhëzës në Kosovë”**

ndodhet në diskutim publik 7 ditë nga data 10.09.2024 deri me datë 17.09.2024

Njëkohësisht në diskutim publik ndodhet edhe raporti i vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni në përbërje:

1. Prof.Asoc, Dr. Jehona Shkodra, kryetar,
2. Prof. Dr. Arben Musliu, mentor - anëtar,
3. Prof.Asoc. Dr. Vahid Avdiu , anëtar

Ekzemplarin e draftit të temës dhe raportin e vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni mund ta kërkonte te udhëheqësi shkencor i temës Prof. Dr. Arben Musliu përmes e-mail adresës: arben.musliu@uni-pr.edu .

Për të pasur një informacion paraprak më poshtë e gjeni një përmbledhje të shkurtë përmes abstraktit të temës.

Çdo sugjerim i juaji mund të jetë një pasurim i punës tonë !

ABSTRAKT

Dredhëzat, që i përkasin gjinisë *Fragaria* nga familja *Rosaceae*, janë ndër frutat më të prodhuara dhe më të konsumuara në nivel global, me kërkesën e tyre në treg në rritje për shkak të aromës së tyre tërheqëse dhe përbërjeve të dobishme bioaktive . Ky studim hulumton ndikimin e mënyrës së kultivimit në produktivitetin dhe profitabilitetin e fermave të dredhëzës në Kosovë. Duke analizuar të dhënat nga 117 ferma të shpërndara në gjithë Kosovën. Të dhënat janë grumbulluar përmes pyetësorit dhe janë analizuar duke përdorur testin Propensity Score Matching (PSM) dhe analizat e regresionit në softuerin R-studio. Rezultatet e hulumtimit ofrojnë një vlerësim krahasues të këtyre dy qasjeve të kultivimit. Kultivimi në ambient të mbyllur si serë rrit ndjeshëm rendimentin dhe përfitimin në krahasim me mënyrën e kultivimit në ambient të hapur. Analiza zbulon se fermat që përdorin serra kanë një rritje mesatare të fitimit prej 7,804€, që është statistikisht domethënëse $p=0.0143$. Kjo metodë lejon një mjedis më të kontrolluar, duke reduktuar rreziqet që lidhen me kushtet klimatike dhe dëmtuesit, dhe duke mundësuar sezone më të gjata të vjeljes si dhe çmime më të larta. Në të kundërtën, kultivimi në ambient të hapur, megjithëse është më pak i kushtueshëm, përgjithësisht rezulton në rendimente dhe fitime më të ulëta, veçanërisht në rajonet me klimë më pak të favorshme.

Gjetjet sugjerojnë se adoptimi i kultivimit në serra mund të përmirësojë ndjeshëm qëndrueshmërinë ekonomike të fermave të dredhëzës në Kosovë. Duke pasur parasysh përfitimet e rendimenteve më të larta dhe frutave me cilësi më të mirë, studimi rekomandon që politikëbërësit të promovojnë bujqësinë e serave përmes stimuljve financiarë dhe programeve të trajnimit të fermerëve. Ky tranzicion mund të jetë vendimtar për rajonet që përballen me sfida klimatike ose ku ka kërkesë për prodhimin e dredhëzës gjatë gjithë vitit. Kultivimi në serë ofron një mundësi më të qëndrueshme dhe më fitimprurëse për kultivimin e dredhëzës në Kosovë, duke e pozicionuar atë si një strategji kyçe për rritjen e qëndrueshmërisë ekonomike të sektorit.

Fjalë kyçe: Dredhëza, Mënyra e kultivimit, Propensity Score matching PSM, Produktiviteti, Profitabiliteti